



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 2022/Prot.  
3

Gramsh, më 03.06. 2026

V E N D I M

Nr. 39 , datë 29.05 2026

PËR  
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA  
FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIM E OPERIM TË  
HEC "SHIROKU" NGA SHOQËRIA "DELIU 3D" SH.P.K.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29.05.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, Sektori i Administrimit të Pyjeve, mbështetur në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr.107/2014, datë 03.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", VKM-në nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre" në V.K.M-në nr.591, datë 09.10.2018, Për disa ndryshime në vendimin nr.1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar, në VKM-në nr.592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor" të ndryshuar, VKM-në nr.267, datë 27.04.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca nr.1 (tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar

për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond), shtojca nr.3 (tarifat për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore), të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, (pika 22), Këshilli Bashkiak:

### V E N D O S I:

- Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik, për ndërtimin dhe operimin e Hec “Shiroku”, nga Shoqëria “DELIU 3D” shpk të fondit pyjor publik të sipërfaqjes prej 0.025 ha (250 m<sup>2</sup>) për ndërtimin e godinës së Hec “Shiroku”, në nënngastrën nr.23b, të ekonomisë pyjore “Holtë-Lukovë”, Njësia Administrative Poroçan në territorin administrativ të Bashkisë Gramsh.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, Sektori i Administrimit të Pyjeve, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
- Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**XHULIA GJINI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**ENIS ZANI**

